



Pranuar / Dorezuar / Prijeno / Prodato Received / Delivery		20.04	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix		Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHCK	1512/2021			119	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.161/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.161/2021 të datës 19.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Objekti i Ish-Rilindjes, kati 11, zyra numër 17, Komuna Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministrisë së Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. RFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr.161/2021 e datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesit, me datë 19.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me Nr. Prot: 1282/2021, kundër Ministrisë së Pushtetit Lokal me pretendimet ankimore se i është mohuar e drejta nga numri i përgjithshëm i ditëve të pushimit vjetor si dhe i është publikuar dosja e të dhënave personale nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në prezencë të anëtarëve në njërin nga punëtorit e organizuara nga institucioni.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.03.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Pushtetit Lokal. Ndërsa Këshilli me datë 31.03.2021 ka pranua nga Ministria e Pushtetit Lokal, përgjigjen në kërkesë me numër protokollit: 748/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:1282/2021 të datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dosjen e punës jashtë orarit të datës 26.05.2020 për muajin mars 2020; Shkresën e datës 19.03.2021 të Sistemit të Informimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me përmbajtjen e numrit të ditëve të pushimit vjetor për vitin 2021 dhe ditëve të pushimit të pashfrytëzuara të vitit 2020; E-mailin e datës 18.01.2021 dërguar nga Sindikata e Shërbyesve Civil të MAPL-së dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë; Kërkesa e datës 10.03.2021 për iniciimin e procedurës disiplinore drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm; E-mailin e datës 10.03.2021 dërguar nga Sindikata e Shërbyesve Civil të MAPL-së dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë; Shkresën e datës 19.03.2021 të Sistemit të Informimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me përmbajtjen e të dhënave dhe kualifikimeve personale; Diploma e ankuesit për përfundimin e Fakultetit Juridik-UP e datës 02.10.2019 me numër Nr:2171; Vërtetimin për kopjen e origjinalit e datës 03.02.2020; E-mailin e datës 19.03.2021 e dërguar nga ankuesi në KPMSHCK e protokolluar me datë 20.03.2021 dhe numër: 1311/2021 për plotësimin e ankesës së datës 19.03.2021 me faqe1/7; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.03.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 31.03.2021; Kontratën e punës së ankuesit të datës 25.10.2010; Ndryshimi dhe plotësimin e Akt Emërimit të ankuesit të datës 13.11.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për ankuesin; Dosja e ankuesit e pushimit vjetor 2020; Kërkesa për pushim e datës 18.12.2021; Shkresën e printuar të Sistemit të Informimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me përmbajtjen e numrit të ditëve të pushimit vjetor për vitin 2021 dhe vitit 2020 dërguar nga institucioni punëdhënës; Deklaratën e znj. udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore të datës 30.03.2021; Listën për vijueshmërinë e ankuesit në punë për periudhën kohore prej datës 02.12.2020 deri me datë 30.12.2020 e lëshuar me datë 30.03.2021; E-mailin e datës 31.03.2021 i cili në KPMSHCK është regjistruar me datë 01.04.2021 dhe numër protkoll:1519/2021; vendimin për caktimin e stafit esencial në Ministrinë e Pushtetit Lokal i datës 14.12.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.161/2021 e datës 19.03.2021, e parashtruar nga ankuesit është **pa e bazuar**, sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi Driton Xhafa e ka themeluar marrëdhënie punë pranë Ministrisë së Pushtetit Lokal me rastin e nënshkrimit të kontratës së datës 25.10.2010 në pozitën “Zyrtar Ligjor”, ndërsa në bazë të plotësim ndryshimit të Akt Emërimit të datës 13.11.2013 ankuesi mbanë pozitën “Zyrtar për monitorimin e komunave” në Divizionin e Monitorimit të Komunave/Departamenti Ligjor për Monitorimin e Komunave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se i është mohuar e drejta nga numri i përgjithshëm i ditëve të pushimit vjetor të vitit 2021 pasi që ankuesi ka mbi 10 (dhjetë) vite përvojë punë dhe se sipas Ligji për Shërbimin Civil të njëjtit i takojnë 5 (pesë) ditë pushim sipas formulës ku për çdo 2 (dy) vite përvojë pune i takon 1 (një) ditë pushim shtesë, ndërsa në Sistemit të Informimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore i figurojnë vetëm 2 (ditë) pushim duke u dëmtuar prej 3 (ditësh), si dhe i është publikuar dosja e të dhënave personale nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në prezencë të anëtarëve në njërin nga punëtorit e organizuara nga institucioni me datë 11.02.2021.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 18 paragrafi 3, 4 dhe 5 i cili përcakton se: “Orët e punës të zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës, 4. Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës, 5. Kriteret dhe kushtet e orarit të punës dhe të pushimeve përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për punë”, dispozitat e Rregullores Nr. 12/2020 për Pushimet dhe orarin



e Punës të Zyrtarëve Publik neni 9 paragrafi 1 dhe 2 i cili përcakton se: “Zyrtari publik për çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej njëzet (20) ditëve. 2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni zgjatja e pushimit vjetor përcaktohet varësisht nga stazhi i punës, ku për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës, shtohet një (1) ditë punë”, si dhe edhe dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 neni 32 paragrafi 2 i cili përcakton se: “Zgjatja e pushimit vjetor përcaktohet varësisht nga stazhi i punës, ku për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës, shtohet një ditë pune”, andaj bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Kolegji konstaton se secilit nëpunësit civil në rastin konkret ankuesit i garantohet e drejta prej 20 (ditësh) ditësh pushim vjetor, ndërsa nga përvoja e punës sipas provave të ofruara respektivisht kontratës së datës 25.10.2010 mbi themelimin e marrëdhënies së punës në Ministrinë e Pushtetit Lokal, ankuesi punën e ka filluar nga data 01.11.2010 dhe deri në momentin e parashtrimit të ankesës në Këshill, i ka 10 (dhjetë) vite e 5 (pesë) muaj përvojë pune, andaj ankuesit i takojnë 2 (dy) ditë shtesë pushim, nga kjo rrjedh se pretendimi i ankuesit që sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nga përvoja e punës prej 10 (dhjetë) viteve i takojnë 5 (ditë) shtesë pushim është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar ngase me hyrjen në fuqi prej datës 09.07.2020 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik në nenin 85 është përcaktuar se: “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozita e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 46 paragrafi 1 i cili përcakton se: “Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore”, dhe dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë neni 6 paragrafi 1 përcakton se: “Nëpunësit civil të institucionit, kur kanë dijeni apo dyshojnë për shkelje disiplinore, të kryera nga nëpunësit të tjerë të të njëjtës institucion, duhet të raportojnë atë me shkrim Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të nëpunësit civil për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen”, si dhe neni 7 paragrafi 4 i së njëjtës rregullore përcaktojnë se: “Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës dhe fakteve të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesit me datë 10.03.2021 ka parashtruar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj Udhëheqëses së Divizionit të Burime Njerëzore tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Pushtetit Lokal i cili është edhe udhëheqës i drejtpërdrejt i palës ndaj të cilës është kërkuar iniciimi i procedurës disiplinore, ndërsa Këshilli nga në kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.03.2021 në mes tjerash ka kërkuar, citojmë: “Dëshmi nëse Sekretari i MPL ka ndërmarr veprime procedural për iniciimin e procedurës disiplinore”, kurse institucioni në përgjigjen në kërkesë të datës 31.03.2021 si dhe atë të datës 01.04.2021 më numër protokoll:1519/2021 nuk ka potencuar nëse Sekretari Përgjithshëm i Ministrisë së Pushtetit Lokal të ketë ndërmarrë ndonjë veprim procedural, andaj me këtë rast Këshilli vlerëson se procedurat disiplinore nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë inicohet në rastet siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik në nenin 7 paragrafi 4 i cili përcakton se: “Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit”, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se Sekretari i Përgjithshëm me rastin e mos iniciimit të procedurës disiplinore ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ndërsa pretendimi ankuesit është i pabazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 në paragrafi si dhe nenin 18 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.161/2021

Flakron Gashi



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref Shabani



Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Pushtetit Lokal, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

